URDHËR
Nr. 118, datë 28.2.2019

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Z. Kostandin Shkurti, të ndjekë dhe të nënshkruajë, çështjet që kanë të bëjnë me:

a) hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore në fushën e sportit;

b) zbatimin e politikave shtetërore në fushën e edukimit fizik dhe sportit në sistemin arsimor;

c) hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për organizimin e zhvillimin e sportit;

d) përmbushjen e objektivave të parashikuara në Planin 300-ditor të Qeverisë, për pjesën që i përket sportit;

e) sigurimin e bashkëpunimit me organizatat sportive dhe Agjencinë e Shërbimit të Sporteve, si institucioni që mbështet aktivitetin e tyre për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administrimin e objekteve sportive publike, që ka në juridiksion;

f) mbështetjen dhe përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore nëpërmjet sportit;

g) problematikat që parashtrohen nga organizatat sportive në Republikën e Shqipërisë (Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar; federatat sportive; shoqatat sportive; shoqëritë sportive; klubet sportive);

h) monitorimin në vazhdimësi të marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet organizatave sportive dhe institucioneve të pushtetit qendror e vendor;

i) ushtrimin, në mungesë dhe me porosi të ministrit, të kompetencave në fushën e sportit;

j) nxjerrjen e urdhrave për miratimin e statutit apo ndryshimeve statutore të federatave shqiptare dhe Organizatës Kombëtare Antidoping;

k) heqjen e emërtimit "Federatë Shqiptare", në rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin";

l) i propozon ministrit pezullimin e dhënies së grandit apo ndryshimin e destinacionit të tij, nëse konstatohet se nuk zbatohen kërkesat e udhëzimit të përbashkët nr. 4, datë 11.3.2014, "Për mënyrën e përdorimit të fondit "Grant/Transfertë korrente e brendshme" për Federatat Sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar", ose për arsye/shkaqe të tjera të motivuara;

m) mbajtjen e marrëdhënieve me EPAS (organizata evropiane përgjegjëse për politikat e sportit pranë Këshillit të Evropës);

n) monitorimin e analizave antidoping;

o) trajtimin e sportistëve elitarë sipas kërkesave të federatave;

p) miratimin e kërkesës së federatave të një sporti të caktuar për organizimin e veprimtarive zyrtare me karakter ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë;

q) kryesimin në Këshillin e Lartë të Sportit.

2. Zëvendësministri mund të kërkojë informacion me shkrim për çdo korrespondencë shkresore të administratës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet në fushën e sportit.

3. Ngarkohet zëvendësministri, që brenda 10 ditëve nga miratimi i këtij urdhri, të detajojë planin e punës me veprimet dhe afatet konkrete për përmbushjen e detyrave të përcaktuara më sipër. Plani i punës miratohet nga ministri.

4. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat e tjerë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështje të caktuara, që konvergojnë në fushën e përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendës-ministrave.

5. Ngarkohet stafi administrativ i ministrisë dhe institucionet e varësisë, që të asistojnë dhe mbështesin zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

6. Ngarkohet zëvendësministri, z. Kostandin Shkurti, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini